

VENDIM
Nr.34, datë 26.9.2005

MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMEVE “SIGMA”
SHA PËR VITIN 2004

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenet 111, 126 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. për arritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese të llogaritur në shumën 184 185 936 lekë, të paraqesë në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve një plan masash, për arritjen e këtij niveli, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për këtë vendim, duke përfshirë objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre, si dhe afatet përkatëse.

2. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a të përmbushë planin e masave brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. ndalohet të shpërndajë fitim për vitin 2004. Fitimi i vitit ushtrimor 2004 të shkojë për rritjen e kapitalit të shoqërisë SIGMA sh.a.

4. Shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. të bëjë provigjionimin për shumën 56 647 070 lekë si më poshtë:

Paradhënie	6 000 000 lekë;
Debitorë	50 647 070 lekë.

5. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve SIGMA sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba